

RIFINITURA



GRAFIATO SILIKONI

Ngjyra	Paketimi
E bardhë	Kovë, 25 Kg

Granulati	Konsumi
1R	2.7 kg/m ²
1V	2.7 kg/m ²
1.5R	3.0 kg/m ²
1.5V	3.0 kg/m ²
2R	3.1 kg/m ²
3R	3.5 kg/m ²

PËRSHKRIM

Veshje dekorative silikonike për përdorim fasadash të jashtme. Është një produkt ekologjikisht i testuar i prodhuar në bazë të teknologjisë HTT që bën të mundur ajrosjen e murit dhe parandalimin e mykut. Ky produkt nuk lejon plasaritjet dhe nuk lejon që papastërtitë të unifikohen me të, kështu që arrin të vetëpastrohet shumë lehtë. GRAFIATO SILIKON karakterizohet nga cilësitë e mëposhtme:

- Lejon përshkueshmërinë e murit ndaj avujve.
- Formon një strukturë të qëndrueshme.
- Mbyll plasaritjet e suvave me bazë çimento -gëlqere.
- Formon një strukturë të bukur dhe mbrojtëse ndaj agjentëve atmosferike.
- Karakterizohet nga një punueshmëri dhe hapje mjaft e mirë.
- Karakterizohet nga një kohë e gjatë punë (nuk thahet).
- Produkt i thjeshtë për t'u aplikuar.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për krijimin e veshjeve dekorative me cilësi mjaft të mirë hidroizoluese, ngjytëse dhe elastike. Përdoret për krijimin e veshjeve dekorative mbi sipërfaqe të mbushura me llaç çimentoje dhe llaç themelor termoizolues.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti ku do të aplikohet Grafiato Silikoni paraprakisht duhet të pastrohet nga pluhurat si edhe mbetjet e naftës, vajrave, verniqeve, dyllit dhe nga materialet ngjytëse. Pastrimi i tyre realizohet në mënyrë manuale. Përpara aplikimit të Grafiato Silikoni suporti duhet të rrafshohet dhe nivelohet me Ecoliner ose Bondex, e me pas të lyhet me Astar Grafiato. Suportet duhet të jenë të sheshta dhe mekanikisht të qëndrueshme.


APLIKIMI

Produkti përzihet derisa të formohet një masë homogjene dhe lehtësisht e aplikueshme. Përzierja mund të bëhet me një përzierës elektrik me xhiro të ngadalta. Duhet treguar kujdes që përzierësi të jetë plotësisht i pastër nga mbetje pigmentesh të ndryshme për të shmangur çdo ndryshim në produktin e formuar. Aplikimi i produktit realizohet në mënyrë manuale nëpërmjet një malle, dhe punohet në drejtim horizontal, vertikal ose rrethor në varësi të efektit estetik që dëshiron të realizosh. Punueshmëria varet nga temperatura e ambientit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pastë	Densiteti: $1,85 \pm 0.05$ kg/lit
Paketimi: Kovë plastike 25 kg	Forca ngjitëse: 1.4 N/mm ²
Ngjyra: E bardhë	Përcjellshmëria e avujve: V2, E mesme
Djegshmëria: I padjegshëm	Durueshmëria: 1.9 N/mm ²
Rezistenca ndaj lagështirës: E mirë	Përcjellshmëria termike: 1.11 W/(mK)
pH i përzierjes: 8-9	Absorbimi i ujit: W3, E ulët
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C dhe lagështia relative më e ulët se 80%	Magazinimi: Ruhet në vende të mbrojtura nga ekspozimi në diell. Mbrojeni nga ngricat.
Ruajtja: 24 muaj në paketim origjinal dhe në vend të freskët.	



Gjatë aplikimit të produktit duhet pasur kujdes që temperatura e ambientit të jetë më e madhe se 5°C dhe me e vogël se 35°C si dhe duhet mënjanuar kontakti i fytyrës me produktin duke qënë se është produkt i klasifikuar si irritues në kontakt me fytyrën. Ekspozimi direkt ndaj diellit, shiut, erës, lagështisë ndikojnë në ngjyrën dhe cilësinë e produktit.